

## ETIKA E MËSIMDHËNËSIT

**Betimi i mësuesit:** “Suksesi i nxënësve në nxënie është brenga ime kryesore, prandaj me bindje të plotë deklaroj se profesionin e mësimit do ta ushtroj:

- me nderë,
- përkushtim, dhe
- besnikëri;

duke qenë korrekt e tolerant në bashkëpunim me:

- nxënësit,
- kolegët, dhe
- komunitetin.

### **Kodi etik i mësimit në Kosovë**

Të drejtat e njeriut, përkatësisht të drejtat e fëmijëve, i takojnë çdo individ, pa asnjë dallim dhe pa asnjë përjashtim.

Nevojat konkrete, interesat konkrete të qytetarit, i kanë shtyrë, i kanë detyruar njerëzit të luftojnë me këmbëngulje për jetësimin e të drejtave të tyre.

Të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, nuk janë dhënë, nuk janë fituar as lehtë as shpejt.

Nevojat (materiale, shoqërore, shpirtërore) të njeriut dhe të shoqërisë janë në rritje. Në rritje janë edhe kërkesat për të drejtat e njeriut dhe për të drejtat e fëmijës.

Përbushja e nevojave (në rritje) të qytetarëve nuk është e kënaqshme. Nuk është e kënaqshme as niveli i jetësimin të të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të fëmijëve, as në nivelin kombëtar as në nivelin ndërkombëtar.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për nivelin lokal, familjar dhe personal.

Ka ligje të avancuara, në shoqëri të ndryshme, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, por zbatimi i tyre nuk është në nivel të kënaqshëm.

Mosrespektimi, mosjetësimi i të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të fëmijëve, haset edhe brenda familjes: bashkëshortëve, fëmijëve, gjeneratave.

Në Kartën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1948), janë shpallur të drejtat universale të njeriut për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim dhe pa asnjë përjashtim.

Meqenëse fëmijët kanë nevojë për mbrojtje, për ndihmë dhe për përkrahje të veçantë, u miratua një konventë e veçantë, KDF-ja (1989), në të cilën parashiheshin vetëm të drejtat e fëmijëve.

Në këtë konventë janë shpallur të drejtat e fëmijëve për: mbijetesë, zhvillim, mbrojtje, pjesëmarrje, etj.

Edukatorët, mësime dhënësit duhet të përqëndrohen në jetësimin e të drejtave të fëmijëve për **ZHVILLIM**, në të cilat përfshihen të drejtat e fëmijëve për:

- arsim-edukim,
- veprimtari kulturore,
- kohë të lirë dhe zbavitje, dhe
- të drejtat e pjesëmarrjes.

Shkolla dhe edukatorët, mësime dhënësit, janë përgjegjës për jetësimin e këtyre të drejtave, që përfshihen në të drejtën e fëmijëve për zhvillim.

Shkolla, në kuadër të detyrave dhe të obligimeve të saj, krijon një klimë të volitshme për realizimin e të drejtave të njeriut dhe të të drejtave të fëmijëve.

Shkolla, përmes edukimit, kultivon tolerancën si pasuri të shoqërisë, që duhet të mbrohet dhe të zhvillohet vazhdimisht.

Arsimtari nuk duhet të jetë i vetmuar për zhvillimin, realizimin dhe kultivimin e përmbajtjeve të të drejtave të fëmijëve. Ai duhet të përqëndrohet edhe në reflektimin e nxënësve për të drejtat e njeriut.

Vështirësitë në jetësimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë:

1. Në aspektin teorik, të gjithë mësime dhënësit nuk janë aftësuar njësoj me njohuri përkatëse për të drejtat e fëmijëve,
2. Të gjithë mësime dhënësit nuk posedojnë njësoj shkathtësi të nevojshme metodologjike për t'i kultivuar te nxënësit dituritë për të drejtat e fëmijëve,
3. Disa arsimtarë nuk e ndjejnë vetën kompetentë në fushë të të drejtave të njeriut,
4. Jo të gjithë mësime dhënësit i kuptojnë njësoj obligimet dhe përgjegjësitë që burojnë nga Kodi Etik i mësime dhënësit.

Mësuesi është vetëm njëri nga faktorët, i cili nxënësit i aftëson në mënyrë të organizuar:

- të zotërojnë njohuri për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në familje, në shkollë e më gjerë, pastaj
- t'i kërkojnë të drejtat e tyre dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj shoqërisë, dhe
- të mos i lëndojnë të drejtat e të tjerëve.

Shkolla duhet të ndikojë që nxënësit t'i dallojnë të drejtat nga përgjegjësitë, dhe kjo duhet të bëhet në mënyrë të natyrshme dhe pa imponime.

Në shkollë, nxënësit e krijojnë kodin e tyre të mirësjellje, i cili i bënë fëmijët të përgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre.

Të drejtat dhe përgjegjësitë, zhvillimi, kultivimi dhe zbatimi i tyre, duhet të arrijnë në shkallën e natyralizimit, të zbatimit automatik të tyre.

Kjo do të thotë krijimin e një sistemi të vlerave dhe krijimi i kodeve përkatëse:

1. Kodi i sjelljeve të pëlqyeshme: veprimet individuale të pëlqyeshme. Këto janë shndërruar në vlera të pranueshme, janë legjitimuar, janë përvetësuar nga individët dhe zbatohen gjerësisht në shoqëri.

Kodi i Sjelljeve të Pëlqyeshme ndryshon vazhdimisht, aq sa mund të flitet për kode të ndryshme specifike të pëlqyeshme.

Çdo shoqëri e ka kodin specifik të sjelljeve të pëlqyeshme. Kjo dukuri është bartuar në institucionet arsimore.

Normat e parapara me kodin e sjelljeve të pëlqyeshme shpesh janë të obligueshme.

2. Kodi i Nderit: virtytet individuale të përgjithësuara në nivel të komunitetit, të vendit, të institucionit.

Ky kod është nxjerrë nga koncepti “njeri i ndershëm”: e mban premtimin, ka parime morale të shëndosha, është i fisëm, nderon veten dhe të tjerët, është i butë, i durueshëm, tolerant, etj.

Këto virtyte janë renditur në një kod të veçantë, për t'u zbatuar nga pjesëtarët e një komuniteti.

3. Kodi i Mirësjelljes: rregullat që duhet të respektohen nga të gjithë anëtarët e komunitetit. Punën dhe jetën në komunitet, këto rregulla, e bëjnë harmonike dhe produktive.

Këto rregulla duket sikur e kufizojnë lirinë e individit, por ato, në fakt, e zgjerojnë lirinë e veprimit të tij: njeriu e ndjen veten më të sigurt, vepron më lirshëm, e di se sa e ka lirinë e veprimit dhe kah mund ta orientojë aktivitetin e tij. Ky kod, prandaj, është i domosdoshëm për institucionet arsimore.

4. Kodi Etik: sistem vlerash, obligimesh e përgjegjësish, të cilat, pas miratimit, bëhen të obligueshme për pjesëtarë e kategori veprimtarish, mosrespektimi i të cilave sanksionohet me ligj.

Funksionimi normal institucional në shumë veprimtari nuk mund të mendohet pa zbatimin e Kodit Etik.

Kodi Etik është lehtësim për ofruesit, por edhe për shfrytëzuesit e shërbimeve.